

# **Statuti i Shoqerise "URBAN ART"**

Sot me 7 Gusht 2023, ne Tirane themelohet Shoqeria me perjegjesi te kufizuar e quajtur "URBAN ART" me ortak unik:

1. Shoqeria "I.F.C" shpk, e regjistruar ne ARBK dhe e identifikuar me nr. Unik Biznesi 810167248, me seli : Zona Industriale, 1000 -Prishtine, Republika e Kosoves, e perfaqsuar nga Drejtori zj. Albulena Dula, banuese ne Prishtine, Republika e Kosoves, e identifikuar me nr. personal ID 1030728277, shtetase e Republikes se Kosoves ;

## **Neni 1**

### **Formimi, Emri dhe Forma ligjore**

Nga pronari i kuotave te krijuara, eshte formuar Shoqeria "URBAN ART" sh.p.k qe rregullohet me dispozitat e Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Shoqeria do ta zhvilloje aktivitetin e saj nen emrin "URBAN ART", shoqeri me perjegjesi te kufizuar e cila si person juridik do te zbatoje dispozitat ligjore në përputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) ("Ligji i shoqërive"). Ortakët e Shoqërisë ("Ortakët ose Ortaku i vetëm") gézojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë të përfaqësuar në kuota ("Kuota"). Shoqeria do te kete logon e saj ne prezantimet dhe shkembimet me te tretet, por nuk do te kete vule.

## **Neni 2.**

### **Objekti i shoqerise.**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "URBAN ART" do te jete në përputhje me legjislacionin shqiptar, nepermjet te cilit Shoqëria ka të drejtë te kryeje:

1. Sipërmarrje, investime dhe pjesemarrje ne fushën e ndërtimit rezidencial, industrial dhe komercial, ne ndërtimin e objekteve te ndryshme, ne dekorimet e jashtme, te brendshme, punime dekorative ne dru, gur, hekur dhe derivatet e tyre;
2. Investime, pjesemarrje, sipermarrje ne fushen e industrise Hoteleri – Turizem dhe ndërtimit rezidencial, turistik duke perfshire te gjitha operacionet komerciale, ndertimore, industriale se bashku me sherbimet perkatese qe konsistojne ne investimin, sipermarrjen, realizimin, blerjen, shitjen, shnderrimin, kompensimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, ndërtimin, restaurimin, montimin e produkteve, materialeve, sherbimeve perkatese specifike ne konceptimin, krijimin, realizimin dhe zhvillimin e nje poli te gjere aktiviteti hotelier-turistik
3. Operacionet ne teresi dhe sherbimet perkatese ne lidhje me konceptimin, realizimin, ndërtimin, arredimin, arkitekturen dhe stilin e brendshem dhe te jashtem te hapesirave perkatese te komplekseve hotelier-turistik.
4. Aktivitet ne fushen e shit-blerjes si dhe te gjithe formave te qerase apo te shfrytezimit me pasurite e tundshme dhe te patundshme (ndertesa, truale, pjese godine etj) si dhe veprimitari te tjera te ngjashme brenda kesaj fushe.
5. Te gjitha operacionet industriale dhe komerciale me sherbimet perkatese qe konsistojne ne blerjen, shitjen, shnderrimin, kompensimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, shperndarjen me shumice dhe pakice, montimin, te te gjitha materialeve dhe kryerjen e sherbimeve sipas legjislacionit ne fuqi; pajisje industriale, produkte dhe derivate industriale, produkte dhe pajisje elektrike, elektronike, aparatura telekomunikacioni dhe aksesoreve te tyre, motorgeneratore dhe komponentë të tyre, centrale të energjisë, motorëve ne të gjitha aplikimet e tyre (industriale, marine, etj) pajisje dhe aplikime ne sistemin



e nderprerjes, te mbrojtjes, të rregullimit dhe stabilizimit të energjisë e tensionit, distribucion te materialeve elektrike për instalime, aplikime te ndryshme, mbrojtese dhe komutimi industrial e rezidencial, në tension të ulët, të mesëm dhe të lartë, paisje dhe aplikime ne industri, transport, shitblerjet e energjise elektrike etj.

6. Investime dhe pjesmarrje ne fushen e industrise, energjise, telekomunikacionit, ndertimit, transportit, hotelerise, turizmit, e te shfrytezimit hidro-ekonomik te pasurise ujore, minerale, energjitike brenda dhe jashte vendit, si dhe investime e pjesemarrje ne investime ne shoqeri te tjera (vendase ose te huaja).
  7. Investime e pjesemarrje ne investime ne fushen e permiresimit te teknologjise se perpunimit te mallrave e artikuje te ndryshem si dhe te konservimit e ambalazhimit te tyre.
  8. Pergatitjen dhe trajnimin e stafit teknik ne fushen e prodhimit te materialeve te ndryshme ne baze druri, guri dhe derivateve te tyre, dhe si vendosjen ne dispozicion e stafit te pergaatitur per shoqeri te tjera, sipas marreveshjeve dhe kontratave perkatese.
  9. Sherbime, konsultime e operacione komisionare si ndermjetes ne operacione tregtare, financiare, ne fusha te ndryshme; aktivitet prodhime e investimesh ne fusha te ndryshme.
  10. Aktivitet ne fushen e shitblerjes si dhe te gjithe formave te qerase apo te shfrytezimit me pasurite e tundshme dhe te patundshme (ndertesa, trualle, pjese godine etj) si dhe veprimtari te tjera te ngashme brenda kesaj fushe.
  11. Aktivitet, sherbime sociale, tregtare e kulturore, ne fushen e turizmit si dhe zhvillim te veprimtarise turistike, aktivitet ne fushen e botimeve, shtypit dhe reklames, ne fushen e mjeteve te komunikimit masiv (televizion, radio, gazeta etj).
  12. Realizimin dhe mundësimin e trajnimeve profesionale dhe pergaatitjen artistike-teknike profesionale për punëmarrësit e saj, duke i vene ne dispozicion edhe per palë të treta.
  13. Kryerjen e çdo transaksiuni në lidhje me aktivet e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktiviteti tregtar, financiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, vendosjen e pengjeve, hipotekave dhe çdo barrë tjetër siguruese që mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë.
  14. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.
  15. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.
- Veprimtaria e shoqerise mund te zgjerohet e kompletohet ne vazhdimesi, kurdohere ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

### Neni 3

#### Selia dhe zhvillimi i aktivitetit

Shoqeria "URBAN ART" shpk ka per seli qendrore dhe do te zhvilloje aktivitetin e saj prane shoqerise "Amadeus Palace" shpk , ne adresen Autostrada Tirane-Durres, KM 7, Kashar, Tirane.

Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ne rast transferimi apo hapje dege / zyre jashtë kufijve te Republike se Shqiperise, ky vendim do te mbetet ne kompetence te plote te Asamblese se Pergjithshme .

### Neni 4

#### Kohezgjatja

Afati i kohezgjatjes se Shoqerise eshte per kohe te pacaktuar duke filluar qe nga data e regjistrimit ne QKB, pervec rastit te shkrirjes se parakoheshme ose te pushimit te aktivitetit per periudhe te perkohshme te vendosur nga Asambleja e Pergjithshme.

### Neni 5



## **Kapitali**

Gjate themelimit, Shoqerise i vihet ne dispozicion kapitali themelor.

Kapitali themelor eshte caktuar 100,000 ALL (njeqind mijë LEKE).

Ai ndahet ne 1(nje) kuote prej 100,000 ALL (njeqind mijë) LEKE.

Kuotat e themeluesve jane si me poshte:

1. Shoqeria "I.F.C." shpk eshte poseduese e 1 (nje) kuote me vlore nominale 100,000 ALL (njeqind mijë ).

Kuotat jane 100% (njeqind perqind) ne pronesi te themeluesve.

## **Neni 6**

### **Llogaria rrjedhese**

Ortaket do t' i dorezojne Shoqerise fonde ne llogari rrjedhese; modalitetet e funksionimit te ketyre llogarive do te vendosen ne cdo rast nga Asambleja e Përgjithshme.

## **Neni 7**

### **Ndryshimi i kapitalit shoqeror**

Kapitali shoqeror mund te rritet me te gjitha menyrat e autorizuara nga ligji.

Sipas Ligjit ne fuqi, Asambleja e Përgjithshme eshte e vetmja kompetente per te vendosur rritjen e kapitalit duke iu permabjatur udhezimeve qe kerkon Ligji.

Ne perputhje me Legjislacionin ne fuqi, ortaket kane proporcionalisht, lidhur me shumen e kuotave te tyre, te drejten e preferences se nenshkrimi te kuotave me para ne dore, duke filluar nga dita kur kjo rritje kapitali eshte bere definitive.

Kerkesat per fonde u behen te ditura paguesve se paku 15 dite para dates se caktuar per cdo derdhje, me njoftim me shkrim, te drejtuar secilit titullar te kuotave.

Cdo vonese e derdhjes se shumave te caktuara qe i perkasin shumes se padorezuar te kuotave, me te drejte te plete dhe pa patur nevoje te veprohet me ndonje formalitet cfaredo, kerkon pagesen e interesit ligjor, duke filluar nga data e kerkeses, pa hequr te drejten e Shoqerise ne zbatimin e ligjit kunder ortakut fajtor.

## **Neni 8**

### **Cedimi dhe transferimi i Kuotave**

Cedimi i ketyre kuotave behet ndaj Shoqerise dhe ndaj te treteve me ane te nje urdher xhirimi midis ceduesit dhe cesonarit. Ky urdher xhirim regjistrohet paraprakisht ne nje register te sigluar, te mbajtur ne menyre kronologjike, i quajtur " Regjistri i Xhirimeve te Kuotave ".

Shoqëria regjistrion kalimin e kuotës dhe ky regjistrim ka efekt deklarativ.

Urdheri i xhirimit me nje formular te dhene dhe te miratuar nga shoqeria nenshkruhet nga ceduesi ose perfaqesuesi i tij; neqoftese kuotat nuk jane te paguara plotesisht, duhen nenshkruar gjithashtu nga cesonari.

Transmetimi i kuotave falas ose ne rast vdekje behet gjithashtu me nje urdher xhirim te transkriptuar ne regjistrin e xhirimeve per te justifikuar ndryshimin dhe sipas nevojes se respektimit te procedures te percaktuar me statut dhe ligj.

Kuotat e pa paguara te derdhjeve te kerkuara nuk jane te pranueshme per kalim.

Shoqeria harton listen e ortakëve duke treguar numrin e kuotave te mbajtura ne adresen e deklaruar nga secili prej tyre.

Sa here qe caktohet një liste, ne regjistrin e xhirimeve shenohet data e saj, numri total i kuotave ekzistuese dhe numri i kuotave qe jane objekt i krijimit, i cedimit, i ndryshimit ose i anullimit qe prej hartimit te listes se fundit.

Me perjashtim te rasteve te trashegimise ne vije te drejtperdreje, te likujdimit te pasurive te perbashketa bashkeshortore ose te cedimit, qofte per nje paraardhes ose nje pasardhes ose ne perfitim te nje personi te trete, cedimi i kuotave ne favor te nje te treti jo ortak, per cdo titull qofte, i nenshtrohet miratimit te Asamblese ne perputhje me kushtet dhe proceduren e parashikuar nga Ligji dhe nga regulorja ne fuqi, duke patur parasysh stipulimet qe vijojne:

- Ne rast mosmarrje te aprovimit dhe brenda 10 diteve te venies ne dijeni, ceduesi eshte i detyruar te informojo Shoqerine me shkrim edhe n.q.s. ai heq dore nga projekt i cedimit.
- Ne qofte se ka vend per ekspertize, shpenzimet e ketij te fundit do te perballohen per gjysem nga shitesi dhe marresi.

Dispozitat e ketij Neni zbatohen ne te gjitha rastet e cedimit midis te gjalleve, qofte falas, qofte me pagese. Keto dispozita jane gjithashtu te zbatueshme edhe ne rast kontributi per Shoqerine, kontribut i pjesshem aktiv, ose per shkrirje ose shperndarje.

## Neni 9

### E drejta dhe detyrimet qe lidhen me kuotat

- I. Cdo kuotë krijon te drejten per perfitime dhe per aktivin shoqeror, me nje pjese proporcionale me pjesën e kapitalit qe ai perfaqeson. Pervec kesaj, kuota i jep te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene e Përgjithshme sipas kushteve Ligjore dhe te Statutit.
- II. Ortakët jane perjegjes te konkurojne me shumen nomimale te kuotave qe zoterojne.
- III. Te drejtat dhe detyrimet qe lidhen me kuotën ruajne titullin e tyre pavaresisht ne cilen dore kalojne.
- IV. Zotërimi i një kuote jep te drejten e plote per te aderuar ne statutin e Shoqerise dhe vendimeve te Asamblese se Përgjithshme.
- V. Trashegimtaret, kreditoret qe kane te drejta ose perfaquesues te tjere te nje ortaku nuk mund te kerkojne vulosjen e pasurive dhe vlerave te shoqerise, as te kerkojne ndarjen, as te perzihen me aktet e administrimit te saj. Qe te ushtrojne te drejtat e tyre, ata duhet t'i referohen inventareve te Shoqerise dhe vendimeve perkatese te Asamblese se Përgjithshme.
- VI. Sa here qe do te jete e nevojshme, posedimi i shume kuotave per te ushtruar nje te drejte te cfarendoshme, ne rast kembimi, rigrupimi ose dhenie titujsh, ose per rrjedhoje, rritje ose pakesim i kapitalit, shkrirje ose veprim tjeter shoqeror, pronaret me tituj te vecante, ose ne nje numer me te ulet nga ai i kerkuar, nuk mund t'i ushtrojne keto te drejta vecse me kusht qe te bejne eventualisht blerjen ose shitjen e titujve te nevojshem.
- VII. Pervec ndonje pengese Ligjore, Shoqeria para se te veproje ne ndarjen ose arketimet gjate ekzistences se saj, ose gjate likujdimit, kuotat e saj ne teresi duhet te perballojne te gjitha taksat ne vend ose perjashtimin prej tyre ashtu si edhe tatimet qe duhet te marre persiper ne menyre te tille qe, duke pasur parasysh vleren nominale dhe gezimin perkates, cdo kuotë te mund te marre te njejtën shume neto.
- VIII. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortakët mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zoterojnë ose nuk kanë paguar ende; Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi që tejkalojnë investimin e tyre përkatesisht në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata realizojnë). Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakëve të saj.

## Neni 10

### Pandashmeria e kuotave

Kuotat jane te pandashme kundrejt Shoqerise.



Pronaret e pandare te kuotave duhet te perfaqesohen prane Shoqerise nga njeri prej tyre, qe konsiderohet si nje pronar i vetem ose si nje mandator i vetem.

## Neni 11

### Administratori i Pergjithshem

Asambleja e Përgjithshme zgjedh nje Administrator te Pergjithshem qe ngarkohet te administroje shoqerine ne aktivitetin e saj. Gjithashtu, ka obligimin te therrase Asamblene dhe te drejtoje debatet. Ai emerohet per kohezgjatjen e mandatit ne Asamblene e Përgjithshme.

Administratori i Pergjithshem eshte person fizik. Administrator I Pergjithshem **caktohet z. Andi Kashi**.

Ne rast te mungeses ose te pamundesise te prezences te Administratorit te Pergjithshem, seanca e Asamblese drejtohet nga mandatuesi i emeruar prej tij ose njeri prej ortakeve i cili do kryeje kryesimin e seances.

## Neni 12

### Pushtetet e Administratorit te Pergjithshem.

Asambleja e Përgjithshme ushtron kontroll te perhereshem ne drejtimin e shoqerise nepermjet Administratorit te Pergjithshem dhe i jep autorizimet paraprake per perfundimin e veprimeve qe ky i fundit nuk mund t'i realizoje pa autorizimin e saj. Administratori raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë. Administratori i paraqet Asamblese se Përgjithshme Vjetore verejtjet e tij ne reportin e drejtorese, ashtu si dhe llogarite e ushtrimit.

Administratori siguron administrimin e perditshem operativ te shoqerise dhe organizon mbikqyrjen e kontrollin periodik te kesaj veprimtarie. Administratori i Pergjithshem i shoqerise ka per detyre organizimin, realizimin dhe kontrollin e aktivitetit operativ te shoqerise mbi bazen e objektivave dhe programeve te punes te orientuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori perfaqeson shoqerine ne marredheniet me personat e trete juridike apo fizike, angazhon shoqerine ne akte qe jane ne perputhje me objektivin e veprimtarise se saj. Ai ka te drejten e firmes per te gjitha aktet administrative te zakonshme, ai ka kompetencen per administrim, perfaqesim dhe ne zbatimin e akteve administrative te zakonshme, ne perputhje me interesat e shoqerise dhe objektivat e Asamblese se Ortakeve.

Administrator I shoqerise duhet te ekzekutoje vendimet e Asamblese se Përgjithshme dhe marredheniet organizative, juridike e financiare ne perputhje me normat e ligjit dhe të ketij statuti. Administratori i shoqerise « URBAN ART » ne veprimtarine e tij eshte i detyruar te kryeje te gjitha veprimet e administratimit ne interes te shoqerise.

Ne rastet kur Administratori i shoqerise mungon per arsyte ndryshme, shoqeria ne marredheniet me te tretet perfaqesohet nga nje person i autorizuar te cilin e ka autorizuar me shkrim administratori.

Ai ka per obligim gjithashtu te therrase Asamblene e Pergjithshme.

Ne cdo periudhe te vitit, Administratori i Pergjithshem ben verifikimet dhe kontrollet, qe i gjykon te pershatshme dhe mund te beje qarkullimin e dokumentave qe i vlereson te dobishme per plotesimin e misionit te tij.

Ne nje afat prej tre muajsh, duke filluar nga mbyllja e ushtrimit, Administratori i Pergjithshem duhet t'i paraqese Asamblese se Përgjithshme llogarite vjetore, pas verifikimit dhe kontrollit te tyre.

## Neni 13

### Pagesat e Administratorit



Asambleja e Përgjithshme i akordon Administratorit te Pergjithshem nje page vjetore. Asambleja e Pergjitheshme pervec kesaj, mund t'i akordoje disa antareve te bordit drejtues pagesa te vecanta per misionet ose mandatet qe u ka besuar.

## Neni 16

### Blerja nga Shoqeria te nje pasurie qe i perket nje Ortaku

Kur shoqeria, pas rregjistrimit te saj, fiton nje pasuri qe i perket nje ortaku dhe vlefta e te cilit eshte e barabarte me nje te dhjeten e kapitalit themelor, ngarkohet nje expert per te vleresuar, nen perqejjesine e tij, vleren e kesaj pasurie. Ky expert caktohet me kerkesen e Administratorit te Pergjithshem. Raporti i expertit ashtu sikurse dhe dokumentat e tjera te parashikuara nga Ligji vihen ne dispozicion te ortakeve.

Asambleja e Përgjithshme vendos per vleresimin e pasurise, duke patur kompetence anullimin e blerjes. Shitesi nuk ka vote vendimore, as per veten tij dhe as si mandator.

Megjithate, keto dispozita nuk jane te zbatueshme kur blerja eshte kryer ne kontrollin e nje autoriteti gjyqesor, ose ne kuadrin e veprimeve te perditshme te Shoqerise dhe te perfunduar ne kushte normale.

## Neni 17

### Certifikimi I ushtrimit vjetor

Certifikimi I veprimtarise ushtrohet ne konformitet me dispozitat ligjore.

Ne rastin e certifikimit nga Experti Kontabel I Autorizuar, ai emerohet ose ushtron misionin e tij ne perputhje me Ligjin.

Asambleja e Përgjithshme emeron per nje afat kohor qe e gjykon te arsyeshem dhe sipas dispozitave ligjore.

Experti Kontabel I Autorizuar kujdeset per zbatimin e sakte te Ligjeve dhe te statutit, duke ekzaminuar inventaret dhe llogarite vjetore. Ai i paraqet asamblese vjetore observimet perkatese dhe certifikon apo jo llogarite. Misioni I tij ushtrohet pas emerimit nga Asambleja e Përgjithshme.

Per te siguruar veprimtarine e mire dhe rezultative te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme ka te drejte te urdheroje kryerjen e kontroll-revisionit mbi kete veprimitari.

## Neni 18

### Asambleja e Pergjithshme

#### Mbledhjet dhe funksionimi i Asamblese se Përgjithshme

- I. Vendimet kolektive te Ortakeve merren ne Asamblene e Pergjithshme. Cdo Asamble e Pergjithshme e organizuar rregullisht perfaqeson universalitetin e Ortakeve. Vendimet e Asambleve te Pergjithshme vene perpara detyrimeve te gjithe Ortaket, edhe ne rastet kur ata mungojne ose nuk jane dakord.
- II. Asambleja e Përgjithshme mblidhet aq here sa e kerkon interes i shoqerise, me thirjen e Administratorit te Pergjithshem. Administratori i Pergjithshem duhet te therase Asamblene brenda 15 diteve kur ortaket, te cilët përfaqësojnë te paktën 5 (pesë) për qind të totalit të kuotave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, paraqesin nje kerkesa te motivuar. Ne qofte se kerkesa mbetet pa perqigje, autoret e saj mund te therrasin Asamblene duke njoftuar rendin e dites.
- III. Mbledhjet behen ne zyrat qendrore ose ne nje vend tjeter te caktuar nga njoftuesi. Ne parim mbledhja duhet te lajmerohet pesembedhjete dite para me shkrim, leter, ose e-mail, njoftimi i te cilave duhet te konfirmohet. Por ajo mund te jete verbale dhe pa afat ne qofte se kjo pranohet nga te gjithe aksioneret. Kur Asambleja e pare nuk mund te vendose per shkak te mosplotesimit te numrit te kerkuar te pjesemarresve, Asambleja e dyte dhe ne rast nevoje, thirret te pakten 15 dite perpara, me te njejtat modalite te si e para. Asambleja, mund te kerkohet te thirret edhe nga Eksperti Kontabel i Autorizuar ne rast urgjencë, i cili per kete veprim, i drejtohet Administratorit ose ortakeve per kete qellim.
- IV. Ne cdo lajmerim duhet te permenden ceshtjet kryesore te rendit te dites. Rendi i dites i Asambleve mund vendoset nga autor i lajmerimit. Nje ose disa Ortakë, duke perfaqesuar sasine e kapitalit shoqeror te vendosur me Ligj dhe duke vepruar ne kushtet dhe afatet Ligjore, kane aftesine e te kerkuarit me shkrim, por



- njekohesht edhe me njoftim marrjeje, te perfshirjes ne rendin e dites se Asamblese dhe te projekt-vendimeve. Asambleja nuk mund te diskutoje per nje ceshtje qe nuk eshte e parashikuar ne urdherin e dites, e cila nuk mund te ndryshohet me thirrjen e dyte.
- V. Megjitheate, kur Asambleja e Ortakeve therritet per te vendosur per nje projekt te cedimit te quotave te nje te treti jo ortak, ne kushtet e parashikuara ne nenin 9 te ketij statuti, vendimi i miratimit merret me shumicen e dy te tretave.
- VI. Vendimet e Asamblese mbahen ne nje register, qe nenshkruhet nga ortaket qe marrin pjese ne seance.
- VII. Vendimet e Asamblese evidentohen nga proces verbalet e mbajtura ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe te nenshkruara nga presidenti i seances dhe nga ortaket, ose ne rast mungese te presidentit te seances, nga personi i mandatuar prej tij.

## Neni 19

### Pjesemarrja ne mbledhjet e Asamblese

- I. Cdo ortak ka te drejte te asistoje ne Asamblete e Pergjithshme dhe te marre pjese ne diskutime, personalisht ose me perfaqesim, cilido qofte numri i kuotave qe ai zoteron, me nje vertetim te thjeshte mbi identitetin e tij, te regjistrimit te kuotave te tij te mbajtura nga Shoqeria dy dite para mbledhjes se Asamblese.
- II. Cdo Ortak nuk mund te perfaqesohet vecse nga bashkeshorti (ose bashkeshortja), nga nje i trete i autorizuar prej tij ose nga nje Ortak tjeter. Ne kete rast, perfaquesuesi duhet te justifikoje mandatin e tij.
- III. Perfaquesuesit Ligjore te Ortakeve te pazote ligjerisht dhe personat fizike qe perfaqesojne personat morale Ortakë, marrin pjese ne Asamble, qofshin ata personalisht Ortakë ose jo.
- IV. Cdo Ortak mund te votoje edhe virtualisht (online) apo me korrespondence me ane te nje formulari te vendosur dhe qe i adresohet Shoqerise sipas kushteve te vendosura nga Ligji. Votimi virtual apo me formular, ne rast nevoje, mund te figuroje ne te njejtin dokument, sipas formules se prokures; ne kete rast, duhet te permbole shenimet dhe te dhenat e parashikuara nga dispozitat, ashtu sic e parashikon rregullorja.

## Neni 20

### Flete-prezenca, mbajtja e proces-verbaleve

- I. Ne cdo Asamble mbahet nje flete prezence qe permban indikacionet e caktuara nga Ligji.
- II. Kjo flete prezence, qe sigurohet nga Ortakët e pranishem dhe perfaquesuesit e tyre e ne te cilen jane aneksuar pushtetet e atribuara per cdo perfaquesues, ne rast nevoje, certifikatat e votimit me korrespondence, vertetohen me saktesi nga zyra e Asamblese.
- III. Asambleja kryesohet nga Administratori i Pergjithshem, ne mungese te tij, nga personi i autorizuar prej tij ose nga nje Ortak i zgjedhur posacerisht per kete qellim.
- IV. Ne qoftese Asambleja thirret nga Experti Kontabel i Autorizuar, Asambleja kryesohet prej tij.
- V. Per cdo rast, ne mungese te personit me aftesi ligjore ose te caktuar per te kryesuar Asamblene, kete e zgjedh Administratori i Pergjithshem.
- VI. Administratori i Pergjithshem ka per mision te verifikoje, te vertetoje nenshkrimin e fletes se prezences, te kujdeset per mbarevajtjen e debateve, te rregulloje incidentet e seances, te kontrolloje votat e emetura, te siguroje rregullsine e tyre dhe te kujdeset per mbajtjen e proces-berbalit.
- VII. Proses-verbalet per pilohen dhe kopjet ose ekstraktet e vendimeve dorezohen dhe vertetohen ne perputhje me Ligjin.

## Neni 21

### Vendimet e Asamblejsë së Pergjithshme

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) ndryshimet e statutit;
  - b) pas marrjes në shqyrtim të dokumenteve përkatës, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - c) emërimin, shkarkimin dhe përcaktimin e shpërblimeve të administratorëve, të likuidueseve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar



2. pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
3. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
5. pas marrjes në shqyrtim të dokumenteve përkatës, miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
6. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
7. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
8. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
9. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
10. Vendimin dhe miratimin per te gjitha investimet, cedimin e aktiveveve, perqindjen e pagesave te llogarive te perditshme.

## Neni 22

### Kuorumi, vota, numri i votave

Vendimet per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise merren me tre te katertat (%) e votave te ortakeve pjesemarres. Për këto çështje, që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë (%) e numrit total të votave votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikës 3 të Ligjit 9901 datë 14.4.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Përgjithshme merr vendime, për çështje të tjera nga ato të përmëndura në paragrafin e mësipërm, me me shume se % te votave të ortakëve pjesemarrës.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të parashikuar, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

E drejta e votes lidhur me kuotat eshte proporcionale me kapitalin qe ato perfaqesojne. Vota dhe votimet shprehen, duke ngritur doren, ulur ose ngritur, ose me thirrje emerore, ashtu sic e vendos Asambleja.

## Neni 23

### E Drejta e Komunikimit te Ortakëve

Seicili Ortak ka te drejte te posedoje dokumentat e nevojshme per t'i krijuar mundesi te pranoncohet e te jape gjykimin e tij mbi qeverisjen dhe ecurine e shoqerise. Natyra e ketyre dokumentave dhe kushtet e dergimit apo te venies ne dispozicion, percaktohen nga ligji.

## Neni 24

### Periudha e Ushtrimit.

Viti shoqeror fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtim ben ushtrimi i pare i aktivitetit, i cili perfshin kohen duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB deri me 31 dhjetor 2023.

## Neni 25

### Inventari, Llogarite vjetore.

Ne perputhje me ligjin, mbahet nje kontabilitet i rregullt i veprimeve shoqerore. Ne mbyllje te cdo ushtrimi, Administratori i Pergjithshem nepermjet drejtuesit financier ben inventarin e elementeve te ndryshem te aktivit dhe te pasivit qe ekziston ne ate date. Drejtuesi financier harton gjithashtu bilancin, duke pershkruar elementet aktive dhe pasive dhe duke nxjerre ne menyre te dukshme kapitalet e mirefillta, llogaritjen e rezultatit, duke

permblehdhur aktivet dhe pasivet e ushtrimit, ashtu si dhe aneksin qe ploteson dhe komenton informacionin e dhene nga bilanci dhe llogaritja e rezultatit.

Procedimi behet edhe ne rast mungese ose pamjaftueshmerie te fitimit, me autorizime dhe shpenzime te nevojshme. Gjendja e angazhimeve te miratuara, ose te garantuara nga shoqeria i aneksohet bilancit.

Administratori i Pergjithshem, vendos raportin e drejtimit mbi gjendjen e shoqerise gjate aktivitetit te kryer mbi evolucionin e mundshem te saj, mbi ngjarjet e rendesishme qe kane ndodhur ndermjet dates se mbylljes se ushtrimit dhe dates ne te cilen eshte vendosur, mbi aktivitetet e saj ne fushen e kerkimit dhe zhvillimit.

## Neni 26

### Fiksimi, Caktimi dhe Rindarja e Fitimeve.

#### Kufizimet e shpërndarjeve. Certifikata e Aftësisë Paguese.

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të dekluaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
  - i. aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - ii. shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme dhe e gjykon te arsyeshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
3. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përbush kërkësat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

## Neni 27

### Kapitalet e mirefillta inferiore kundrejt gjysmes se kapitalit shoqeror (themelor)

Ne qofte se nga humbjet e konstatuara me dokumentat e llogarise, kapitalet e mirefillta te Shoqerise behen inferiore kundrejt gjysmes se kapitalit shoqeror (themelor), pas miratimit te llogarive qe evidentojne keto humbje, Administratori i Përgjithshëm detyrohet te therrase Asamblene e Pergjithshme, me qellim qe te vendose per shkrirje, te parakoheshme te Shoqerise, ne qoftese ka vend.

Ne qoftese shkrirja e Shoqerise nuk realizohet, brenda afatit te caktuar me Ligj dhe sipas dispozitave te nenit ne fuqi, kapitali duhet te reduktohet me nje shume te barabarte me ate te humbjeve te konstatuara, ne qoftese gjate ketij afati kapitalet baze nuk jane bere te barabarte te pakten me gjysmen e kapitalit shoqeror (themelor) Ne te dy rastet, vendimi i Asamblese se Pergjithshme shpallet sipas kerkesave qe ka rregullorja. Ne rastin e mosbarazimit te parashikimeve te paragrafeve te mesiperme, cdo i interesuar mund te kerkonte ligjerisht shkrirjen e Shoqerise Kjo vlen edhe ne qoftese aksioneret nuk kane mundur te diskutojne ne menye te pershtatshme.

## Neni 28

### Shkrirja – likujdimi

Perjashto rastet e shkrirjes ligjore te parashikuara me Ligj, do te kete shkrirje te Shoqerise me skadimin e afatit te fiksuar nga Statuti ose me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Vetem ne rast shkrirjeje, skadimi i shoqerise ose shkrirja e saj per ndonje arsy, con ne likujdimin e saj.

Likujdimi behet nga nje ose disa likujdues te emeruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Likujduesi perfaqeson Shoqerine. Ai eshte i veshur me te gjitha pushtetet me te gjera per te realizuar aktivin, edhe me mirekuptim. Ai eshte i afte Ligjerisht te paguaje kreditoret dhe te ndaje bilancin e tyre.

Asambleja e Pergjithshme mund ta autorizoje te vazhdoje ceshtjet ne vazhdim ose te angazhoje te reja per nevojat e likujdimit.



Nje vendim Ligjor hedh poshte pengesen ose urdheron qofte rembursimin e kredive, qofte krijimin e garancive, ne qofte se Shoqeria i ofron dhe ne qofte se ato gjykohen te mjaftueshme. Transmetimi i prones nuk realizohet dhe nuk ka zhdukje te personit juridik vecse ne fund te afatit te kundershtimit ose, ne rast nevoje, vecse kur kundershtimi eshte hedhur ne instancat e para ose kur eshte kryer rimbursimi i kredive ose i garancive te formuara.

### **Neni 29**

#### **Kundershtimet**

Cdo kundershtim qe do te mund te ngruhej gjate kohes se Shoqerise oset e likujdimit te saj, qofte midis ortakëve dhe Shoqerise, qofte midis vete ortakëve persa i perket ceshqjeve shoqerore, do te gjykohej ne perputhje me ligjin dhe do t'i nenshtrohen juridiksionit te organeve gjyqesore kompetente.

### **Neni 30**

#### **Gezimi i personalitetit juridik. - Rimarja e angazhimeve**

Shoqeria nuk do te gezoje personalitet juridik, vecse duke filluar qe nga dita e regjistrimit te saj ne QKB. Megjithate, perpara kesaj dite, per llogari te Shoqerise ne krim, kryhen aktet e caktuara me nje gjendje te caktuar, duke percaktuar per secilin perj tyre angazhimin qe do te rezultonte nga shoqeria. Kjo gjendje do t'i qendroje e aneksuar dokumentave fillestare te shoqerise ne krim. Regjistrimi i Shoqerise do te coje me te drejta te plota ne marrjen nga ajo te te ashtuquajturate angazhime. Pervec kesaj dhe qe tani, ortaket e thirrur per te ushtruar drejtimin e per gjithshem te Shoqerise, autorizohen te realizojne aktet dhe angazhimet qe hyjne ne kuadrin e objektit social dhe te mundesive te tyre ligjore. Pas regjistrimit te Shoqerise ne QKB keto akte dhe angazhime, do t'i nenshtrohen miratimit te asamblese se per gjithshme te Ortakeve te thirrur per te vendosur per llogarite e ushtrimit te pare social. Ky miratim do te coje me te drejta te plota ne rimarrjen nga Shoqeria te akteve dhe angazhimeve qe do te nenshkruhen qe nga origjina e Shoqerise.

### **Neni 31**

#### **Mosmarreveshjet**

Ne rast se gjate jetes se shoqerise lindin mosmarrveshje midis pjesetareve te shoqerise dhe ne marredheniet me te tretet, keto duhet te zgjidhen me mirekuptim (konsensus) dhe ne rast te kundert te zgjidhen nga organet gjyqesore kompetente te parashikuar ne legjislacion.

### **Neni 32**

#### **Konfidencialiteti**

Ortaket themelues, Administratori dhe punonjesit e tjere te shoqerise jane te detyruar :

- I. te zbatojne me rigorozitet legjislacionin ne fuqi, kushtet e ketij Statuti dhe te Kontrates me Shoqerine gjate ushtrimit te detyrate te tyre.
- II. te ruajne sekretin per veprimet ekonomike- financiare dhe te tjera te shoqerise ne marredhenie me te tretet.

### **Neni 33**

#### **Publikimi**

Me qellim qe te behet i njohur krimi i Shoqerise, te gjitha kompetencat ligjore i jane dhene z. Andi Kashi.

- per te nenshkruar, publikuar dhe perfunduar krimin e shoqerise.
- per te proceduar me gjithe formalitetet per regjistrimin e Shoqerise ne QKB dhe gjithe institucionet e nevojshme, dhe ne per gjithes, ne mbajtjen e originalit dhe te nje kopjeje te Statutit te tanishem per te kryer formalitetet e nevojshme me Ligj.

### **Neni 34**

#### **Shpenzimet**

Te gjitha shpenzimet, te drejtat dhe honoraret qe rrjedhin nga akti i tanishem dhe vazhdimet e tij, do t'i takojne bashkarisht dhe ne menyre solidare te nenshkruarve, ne perpjestim me ndihmesat e tyre, derisa Shoqeria te jete rregjistruar ne QKB. Duke filluar qe nga regjistrimi, ato do te merren plotesisht ne ngarkim nga Shoqeria qe do t'i amortizoje perpara cdo shperndarje te fitimeve dhe me vone ne nje afat prej pese vjetesh.

Tirane me 7 Gusht 2023.

Ky statut eshte formuluar ne 3 (tre) origjinale dhe nenshkruar nga palet si me poshte.

## P A L E T

### ORTAKU UNIK

**Shoqeria « I.F.C. » shpk**  
**Perfaqsuar nga Drejtori zj. Albulena Dula**

